



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
*Izborni Panel za Žalbe i Predstavke*

**Anr.683/2021**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, me panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rrustem Thaqi kryesues, Faton Ademi dhe Ferki Xhaferi anëtar, duke vendosur përkitazi me ankesën e Përparim Shala, kandidat për asamble komunale nga Partia Demokratike e Kosovës në Komunën e Drenasit, të paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me objekt të çështjes keqpërdorim i votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 17.10.2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 20.10.2021, mori këtë:

## **V E N D I M**

**HUDHET** e palejuar ankesa Anr.683/2021 e datës 18.10.2021, e paraqitur nga Përparim Shala, kandidat për asamble komunale nga Partia Demokratike e Kosovës në Komunën e Drenasit, e paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak keqpërdorimit të votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 17.10.2021.

## **A r s y e t i m**

PZAP-i, me datë 18.10.2021, ka pranuar një ankesë Anr.683/2021 nga Përparim Shala, kandidat për asamble komunale nga Partia Demokratike e Kosovës në Komunën e Drenasit, më të cilën theksohet se në qendrën e votimit në Llapushnik – Gllogoc nuk më kanë dalë votat e pritura në qendrën e votimit 0317E/01R, 0317E/02R, 0317E/03R dhe 0317E/043. Dyshimet e mija janë se

janë keqpërdorur votat nga persona përgjegjës në qendrat e votimit, për këtë çështje mund të kontaktohen personat kontaktues që kanë deklaruar se kanë votuar për të njëjtin.

Ankesës i ka bashkangjitur edhe deklarata të votuese të cilët pretendojnë se e kanë votuar kandidatin në fjalë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

### **Ankesa është e palejuar**

Paneli nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljet e pretenduar në ankesë përkitazi me parregullsitë, për faktin se shkeljet që ndërlidhen me rezultatin e votimit, duhet të parashtrihen me rastin e shpalljes së rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procesit zgjedhor. Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi përfundimtar mbi shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj Paneli vendosi që ta hudhë si të parakohshme ankesën e ankuesit. Hudhja e ankesës së Përparim Shala, kandidat për asamble komunale nga Partia Demokratike e Kosovës, për komunën e Drenasit nuk e paragjykon çështjen dhe ankuesit nuk i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, të paraqes ankesa tjera, pas shpalljes të rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

**Anr.683/2021 më datën 20.10.2021**



**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.